



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 696 / Prot.
14

Tiranë, më 22/7 /2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Institucionit Arsimor
Parauniversitar jo publik "Kolegji Preka" Korçë.

REKOMANDIM

Nr. 11 datë 22/07 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Kolegji Preka" Korçë.

KONSTATOVA

Në datë 18/06/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Kolegji Preka" Korçë me objekt:

- Ligjshmëria e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Kolegji Preka", në lidhje me kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "nxënës", bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontrolluesi "Kolegji Preka" Korçë është institucion arsimor i mesëm jo publik dhe mbështet punën e tij mbi ligjin 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe mbi të gjitha dispozitat normative për arsimin parauniversitar.

Në këndvështrimin të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Kolegji Preka" në ushtrim të

aktivitetit të tij merr cilësinë e kontrolluesit jo publik, pasi sipas përkufizimit në ligj "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë aspekt ky kontrollues gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij arsimor mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve të të dhënave personale "nxënës".

Gjatë kontrollit administrativ të ushtruar pranë këtij kontrolluesi, hetimi administrativ u zhvillua për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "nxënës" lidhur me faktin se si respektohen nga ky kontrollues kushtet dhe kriteret ligjore të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe udhëzimi nr. 4 datë 16/02/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për "Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit", gjatë procesit të mbledhjes përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për këtë kategori subjektsh.

Rezultoi nga kontrolli administrativ se mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "nxënës" nga kontrolluesi „Kolegji Preka” bëhet në rrugë manuale dhe elektronike, për mbledhjen e të dhënave personale në rrugë manuale kontrolluesi ka hartuar vetë, "formularë aplikimi për regjistrim" të nxënësve, i cili së bashku me dokumentacionin vërtetim shkolle, dëftesa e lirimit, çertifikatë personale, kartelë vaksinimi ISHP, përbën "zarfin" ose dosjen e dokumentacionit të nxënësit /subjekt të dhënave personale.

Nëpërmjet "formularit të aplikimit për regjistrim" kontrolluesi mbledh nga subjektet e të dhënave/nxënës të dhënat e tyre personale si; emër, mbiemër datëlindje, vendlindje, nr. telefoni të tij dhe të prindrit, adresa vendi ku banon, mbledh të dhëna për prindërit, emri i prindrit, nënës babait, punësimi, shkolla 9-vjeçare nga vjen, nënshkrimi dhe data e nënshkrimit nga prindi dhe nëpërmjet kontratës për regjistrim përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

Sa i përket kategorisë së të dhënave personale vlerësojmë se të dhënat personale që kontrolluesi mbledh për kategorinë "nxënës" nëpërmjet „formularit për regjistrim" dhe „kontratës regjistrimit," ato janë të ligjshme, të mbledhura për qëllim specifik, të mjaftueshme dhe jo në tejkalim të qëllimit.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se kontrolluesi "Kolegji Preka" ka krijuar kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit fizik i cili përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave "nxënës". Dokumentacioni është i vendosur në dollapë me akses të kufizuar (mbyllje me çelës), zyra me akses të kufizuar (derë me çelës), siguri nga lagështira apo zjarri si dhe ruajtje e ambienteve fizike me roje.

Kontrolluesi „Kolegji Preka" mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale dhe në rrugë elektronike duke krijuar një regjistër të thjeshtë elektronik në formatin "EXEL", duke përdorur të dhënat e mbledhura manualisht për kategorinë "nxënës"(subjekte të të dhënave personale), në funksion të qëllimit dhe punës së tij. Lidhur me këtë lloj përpunimi të dhënash

vlërësojmë se kontrolluesi ka disa masa sigurie duke kufizuar aksesin në kompjuter me anë të “emrit të përdoruesit” dhe “fjalëkalimit” përkatës. Konstatohet gjithashtu se është instaluar antivirus në të gjithë kompjuterat këtij kontrolluesi.

Pavarësisht sa më sipër nga kontrolli administrativ i zhvilluar pranë kontrolluesit „Kolegji Preka” u konstatua se:

- Kontrolluesi “Kolegji Preka”, nuk ka të hartuar rregullore për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”, duke shkelur dhe mos respektuar në këtë mënyrë nenin 27 dhe 28 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe Udhëzimi nr. 4 datë 16/02/2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”.
- Në “formularët e aplikimit” dhe “kontratat e regjistrimit”, nëpërmjet të cilëve kontrolluesi “Kolegji Preka” mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat personale për kategorinë “nxënës”, nuk ka shprehur qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, marrjen e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimit të të dhënave (nga prindërit) si dhe informimi i subjekteve të të dhënave personale, duke shkelur dhe mos respektuar në këtë mënyrë nenet 5, 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative,

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik “Kolegji Preka” Korçë, të hartojë rregullore të veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.
2. Në zbatim të neneve 5, 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit të veçantë nr. 4 datë 16/02/2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”, të shprehë në “formularët e aplikimit për regjistrim” dhe në “kontratën e regjistrimit”, në mënyrë të shkruar, qëllimin e saktë, të qartë dhe specifik, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “nxënës”(subjekte të të dhënave personale), si dhe të bëjë informimin e këtyre subjekteve të të dhënave personale.

3. Kryerja e detyrave të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 2 (dy) muaj, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Kontrolluesi Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik “Kolegji Preka” Korçë, mbas përmbushjes së këtyre rekomandimeve mbart detyrimin ligjor për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mospërmbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE

